



LËVIZJET EKONOMIKE AFATSHKURTRA



Janar, 2025



PËRMBAJTJA

P Ë R M B L E D H J A.....	2
1. SEKTORI REAL.....	3
Prodhimi industrial	3
Numri i të punësuarve në industri.....	4
Çmimet e shitjes së prodhuesve të produkteve industriale në tregun vendor	4
Indekset e qarkullimit në industri	5
Numri i lejeve të lëshuara të ndërtimit dhe vlera e paraparë e objekteve	6
Numri i punëve të kryera ndërtimore sipas llojeve të objekteve.....	6
Qarkullimi në sektorin e tregtisë.....	7
Inflacioni	7
Çmimet e bursës	9
2. SHKËMBIMI I JASHTËM TREGTAR	11
Eksporti	11
Importi	12
Saldoja e shkëmbimit tregtar	13
Struktura valutore	14
3. SEKTORI FISKAL	14
Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore sipas klasifikimit ekonomik.....	14
Shpenzimet sipas shfrytëzuesve buxhetorë.....	16
4. SEKTORI SOCIAL.....	18
Personat e sapopunësuar dhe personat e regjistruar si të papunë në Agjencinë e Punësimit	18
Pagat	19
Pensionet	19
5. SEKTORI MONETAR FINANCIAR	20
Paratë primare.....	21
Potenciali i depozitave.....	21
Kreditë Bankare.....	22
Normat e interesit të depozitave bankare.....	23
Tregu i kapitalit	23
Rezervat devizore	23



P Ë R M B L E D H J A
E L Ë V I Z J E V E M Ë T Ë R Ë N D Ë S I S H M E E K O N O M I K E A F A T S H K U R T R A
janar, 2025

- Në muajin janar të vitit 2025, prodhimi industrial ka shënuar rritje prej 1.4%, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak;
- Në muajin dhjetor të vitit 2025, çmimet e shitjes së produkteve industriale të prodhuesve në tregun vendor janë më të larta për 6.1%, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar;
- Qarkullimi në industri në muajin janar të vitit 2025, krahasuar me muajin janar të vitit 2024, shënoi rritje për 8.9%;
- Norma e inflacionit në muajin janar të vitit 2025 është 4.9% në nivel vjetor, me ç'rast këtë muaj ajo shënon përshpejtim rritjeje (4.4% në muajin dhjetor të vitit 2024). Në nivel mujor, inflacioni shënoi rritje prej 0.2%;
- Në vitin 2025, eksporti shënoi rritje prej 5.1%, ndërsa importi prej 6.1%, që rezultoi me rritje të deficitit tregtar për 8.1%, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit 2024;
- Gjatë periudhës janar të vitit 2025, realizimi i të hyrave të përgjithshme buxhetore të Buxhetit të RMV-së është 23.313 milionë denarë, që paraqet 6,5% të vlerës së planifikuar për vitin 2025, përkatësisht rritje për 8.7%, krahasuar me të hyrat e realizuara buxhetore, në raport me periudhën janar të vitit 2024;
- Gjatë periudhës janar të vitit 2025, realizimi i shpenzimeve të përgjithshme ishte 26.019 milionë denarë, që paraqet 6.5% të planit vjetor, përkatësisht ulje prej 3.4%, krahasuar me muajin janar të vitit 2024;
- Në muajin janar të vitit 2025, kreditë e përgjithshme të bankave janë rritur për 11.3%, krahasuar me muajin janar të vitit 2024, ndërsa potenciali i përgjithshëm i depozitave të bankave ka shënuar rritje prej 11.0%.



1. SEKTORI REAL





Prodhimi industrial

Në muajin janar të vitit 2025, prodhimi industrial ka shënuar rritje prej 1.4%, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Rritja rezulton nga rritja e prodhimit në sektorin: Industria e përpunimit 4.4%, derisa rënie të prodhimit shënojnë sektori i minierave dhe guroreve për 5.1% dhe ai i furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar për 4.1%.

Rritje të prodhimit në muajin janar të vitit 2025, shënojnë 16 prej 27 degëve industriale të cilat përfshijnë 49.8% të industrisë së përgjithshme.

Nga degët me vlerë të shtuar më të lartë, në muajin janar të vitit 2025 rritje ka shënuar prodhimi i metaleve për 13.5% me kontribut prej 0.5 p.p. dhe prodhimi i makinerive dhe pajisjeve për 2.7% me kontribut prej 0.1 p.p., si dhe prodhimi i pajisjeve elektrike 2.1% me kontribut prej 0.2 p.p., ndërsa rënie ka shënuar dega e prodhimit të automjeteve, rimorkiove dhe gjysmë-rimorkiove prej 11.6% me kontribut prej 2.0 p.p..

Nga degët tradicionale në muajin janar të vitit 2025, rritje e prodhimit shënohet në degët e mëposhtme: prodhimi i tekstileve për 13.0% me kontribut prej 0.6 p.p., industria e produkteve ushqimore për 2.0% me kontribut prej 0.2 p.p.,






prodhimi i produkteve të duhanit për 99.4% me kontribut prej 1.0 p.p, prodhimi i lëkurës për 19.1%, me kontribut prej 0.1 p.p., përpunimi i drurit dhe produkteve të drurit dhe tapës për 107.0% me kontribut prej 0.9 p.p., ndërsa rënie vërehet vetëm në degën e prodhimit të pijeve për 4.7% dhe me kontribut prej -0,2 p.p., si dhe në prodhimin e veshjeve nuk ka ndryshime.

Prodhimi industrial sipas destinimit të njësive prodhuese në muajin janar të vitit 2025, krahasuar me muajin janar të vitit 2024 është rritur në grupin e produktet intermediare përveç energjisë (rritje prej 16.4%, me kontribut prej 4.9 p.p), produktet me afat të gjatë skadence për konsum të gjerë (rritje prej 20.6%, me kontribut prej 0,9 p.p.) dhe produktet me afat skadence të shkurtër për konsum të gjerë rritje prej 2.3% me kontribut prej 0.7 p.p.), ndërsa rënie shënohet në grupet e mëposhtme: Energjia (rënie prej 8.4% me kontribut prej 0.7 p.p), si dhe produktet kapitale (rënie prej 8.3% me kontribut prej -2,1 p.p).

Numri i të punësuarve në industri


Në muajin janar të vitit 2025, numri i të punësuarve në industri ka shënuar rënie për 3.5%, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Rënia vjen për shkak të numrit të reduktuar të të punësuarve në të gjithë sektorët: minierat dhe guroret për 1.7%, industria e përpunimit për 3.7% dhe furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar për 1.5%. Rritje të numrit të të punësuarve vërehet në këto degë: prodhimi i makinerive dhe pajisjeve, të paspecifikuara diku tjetër për 29.2%, prodhimi i produkteve farmaceutike bazë dhe preparateve farmaceutike për 7.8%, si dhe përpunimi i drurit dhe produkteve të drurit dhe tapës, përveç mobiljeve, artikujve prej kashte dhe materialeve thurëse për 5.2%.

Të dhënat për numrin e të punësuarve në industri sipas grupeve të destinimit në muajin janar të vitit 2025, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar, tregojnë se rritje të numrit të të punësuarve shënon vetëm grupi i produkteve me afat të gjatë skadence për konsum të gjerë për 22.3%.



Çmimet e shitjes së prodhuesve të produkteve industriale në tregun vendor

Në muajin janar të vitit 2025, çmimet e shitjes së prodhuesve të produkteve industriale në tregun vendor ishin për





6.1% më të larta, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Rritja vjen si pasojë e rritjes së çmimeve në sektorët: industria e përpunimit për 4.2%, furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar për 17.4% dhe furnizimi me ujë; trajtimi i ujërave të zeza, menaxhimi i mbeturinave dhe aktivitetet e përmirësimit të mjedisit për 4.8%, çmimet e shitjes në sektorin e minierave dhe gurorëve u ulën për 1.1%.

Në muajin janar të vitit 2025, krahasuar me muajin janar të vitit 2024, çmimet e shitjes së prodhuesve të produkteve industriale në tregun vendor janë më të larta në grupet: energjia për 15.9%, produktet intermediare, përveç energjisë 1.7% produktet e konsumit të gjërë për 6.1%, dhe produktet me afat të shkurtër skadence për 6.4%.

Indekset e qarkullimit në industri

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave, qarkullimi në industri në muajin janar të vitit 2025 në raport me muajin janar të vitit 2024 është rritur për 8.9%.


Rritja rezulton si pasojë e rritjes së qarkullimit në: sektorin e minierave dhe gurorëve për 41.4%, dhe sektorin e industrisë së përpunimit për 8.0%.

Në muajin janar të vitit 2025, krahasuar me muajin janar të vitit 2024, qarkullimi në industri është rritur në të gjitha grupet: produktet me afat të gjatë skadence për konsum të gjërë për 15.7%, produktet intermediare përveç energjisë për 13.5 dhe produktet kapitale për 11.0% si dhe produktet me afat skadence të gjatë për konsum të gjërë për 0.6%.

Degët me rritjen më të lartë të qarkullimit në industri në muajin janar të vitit 2025, krahasuar me të njëjtin muaj të vitit të kaluar janë:

- Përpunimi i drurit dhe produkteve të drurit dhe tapës, përveç mobiljeve, prodhimi i artikujve prej kashte dhe materialeve thurëse (rritje prej 68.1%)


Grafiku 1.6: Rritja e çmimeve të shitjes së prodhimeve industriale në tregun vendor sipas grupeve



Grafiku nr.1.7: Rritja e qarkullimit në industri në grupet kryesore industriale



Grafiku 1.8: Lejet e ndërtimit dhe vlera e punëve (numri në njësi; vlera në milionë denarë)



Burimi: ESHS



- Prodhimi i automjeteve motorike, rimorkiove dhe gjysmërimorkiove (rritje prej 48.6%) dhe
- Nxjerrja e mineralit të metalit (rritje prej 42.2%).

Numri i lejeve të lëshuara të ndërtimit dhe vlera e paraparë e objekteve

Në muajin janar të vitit 2025 janë lëshuar gjithsej 317 leje ndërtimi, që paraqet rritje prej 23.8%, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit 2024. Kjo rezulton për shkak të rritjes vjetore të lejeve të lëshuara për objekte të ndërtimeve të larta për 4.8% (të cilat paraqesin 54.9% të numrit të përgjithshëm të lejeve të lëshuara ndërtimit), ndërsa sa i përket rikonstruimit të objekteve shënohet rritje për 121.4%. Krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2024, numri i lejeve të lëshuara të ndërtimit është rriur për 10.5%. Vlera e parashikuar e objekteve sipas lejeve të lëshuara të ndërtimit në muajin janar të vitit 2025 është më e lartë për 28.2% në bazë vjetore dhe krahasuar me muajin paraprak ka shënuar rritje për 16.5%.

Analizuar sipas llojit të objekteve, nga numri i përgjithshëm i lejeve të lëshuara të ndërtimit, 174 (ose 54.9%) janë të destinuara për objektet e ndërtimeve të larta, 50 (ose 15.8%) për objektet e ndërtimeve të ulëta dhe 93 (ose 29.3%) për objekte të rikonstruimit.


Analizuar sipas llojit të investitorëve, nga gjithsej 317 leje të lëshuara ndërtimi, 178 objekte (ose 56.2%) si investitorë janë personat fizikë, ndërsa 139 objekte (ose 43.8%) si investitorë janë subjektet afariste.

Me lejet e lëshuara të ndërtimit në muajin janar të vitit 2025 parashikohet ndërtimi i 759 banesave me sipërfaqe të përgjithshme të shfrytëzueshme prej 60.471m². Numri i banesave të planifikuara për ndërtim është ulur për 7.7% në nivel mujor dhe për 23.4% në nivel vjetor.

Numri i punëve të kryera ndërtimore sipas llojeve të objekteve


Vlera e përgjithshme e punëve të kryera ndërtimore në muajin dhjetor të vitit 2024

Grafiku 1.9: Struktura e lejeve të lëshuara për ndërtim sipas rajoneve (janar 2025)




Burimi: ESHS

Grafiku 1.10: Vlera e parashikuar e objekteve sipas rajoneve (në miliona denarë)



Grafiku 1.11: Punët e kryera ndërtimore (milione denarë)





arriti në 6.356 milionë denarë, që paraqet rritje nominale vjetore prej 19.2%, ku rritje ka në ndërtimet e larta për 12.9%, në ndërtimet e ulëta për 28.8%, ndërsa në punimet e specializuara të ndërtimit ka rënie për 34.9%. Krahasuar me muajin nëntor të vitit 2024, vlera e përgjithshme e punëve të kryera ndërtimore ka pasur rritje për 46.8%, me ç'rast në ndërtimet e larta për 123.6%, te ndërtimet e ulëta për 19.3% dhe në punimet e specializuara ndërtimore për 45.4%. Në mënyrë kumulative, në periudhën janar - dhjetor të vitit 2024, vlera e punëve të kryera ndërtimore arriti në 37.984 milionë denarë, që është 10.5% më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Në kuadër të punëve të kryera ndërtimore, pjesa më e madhe i referohet ndërtesave të ulëta, ku gjatë vitit 2024 vitit janë kryer punë ndërtimore në vlerë prej 24.056 milionë denarëve, përkatësisht 22.9% më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Gjatë kësaj periudhe, vlera e punëve të kryera në ndërtesat e larta është ulur për 6.1% dhe ka vlerë prej 12.729 milionë denarëve, ndërsa në punimet e specializuara ndërtimore është 1.199 milionë denarë, gjegjësisht për 3.6% më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Në bazë reale, vlera e punimeve të kryera ndërtimore në periudhën janar – dhjetor të vitit 2024 është rritur për 19.5%, gjatë rritjes te ndërtesat e ulëta (33.0%), te punimet e specializuara ndërtimore (4.5%) dhe te ndërtesat e larta prej (1.4%).

Qarkullimi në sektorin e tregtisë

Në muajin janar të vitit 2025, të dhënat e tregtisë së brendshme tregojnë rritje nominale vjetore të qarkullimit për 3.8%, pas rritjes prej 4.9% në muajin dhjetor të vitit 2024. Vlera e qarkullimit në muajin janar të vitit 2025 është 61.292 milionë denarë.


Në bazë reale, në muajin janar të vitit 2025, tregtia me pakicë shënon rënie vjetore prej 0.2%, ndërsa analizuar sipas grupeve dhe klasave, vërehet rënie edhe në grupin e tregtisë me pakicë të produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit për 3.4%, ndërsa rritje vërehet në grupet si në vijim: tregtia me pakicë e karburanteve të automobilave për 1.7% dhe tregtia me pakicë e produkteve joushqimeve për 2.1%.

Në muajin janar të vitit 2025, pjesëmarrje më të madhe strukture në sektorin e tregtisë kishte në pjesën e tregtisë me shumicë (54.0%), ndjekur nga tregtia me pakicë (41.5%) dhe tregtia e automjeteve dhe motoçikletave, riparimit dhe mirëmbajtjes së tyre (4.5%).


Inflacioni

Norma e inflacionit në muajin janar të vitit 2025 është 4.9% në nivel vjetor dhe në

Grafiku 1.12: Tregtia me pakicë, ndryshimi real vjetor (%)



Grafiku 1.13: Inflacioni sipas COICOP (normat e rritjes në %)



Burimi: ESHS




këtë muaj sërish regjistroi përsheptim të rritjes (4.4% në muajin dhjetor të vitit 2024). Rritja e inflacionit këtë muaj në masë të madhe rezulton nga komponenti bazë, si dhe komponenti ushqimor që shënon rritje në muajt e fundit.

Në muajin janar të vitit 2025, inflacioni bazë (inflacioni pa ndikimin e çmimeve të ushqimeve dhe energjensave) regjistroi përsheptim të rritjes në krahasim me muajin paraprak dhe shënon 6.3% në bazë vjetore (5.5% në muajin dhjetor). Në këtë muaj, kontribut më të madh pozitiv ka pasur rritja e çmimeve në kategorinë e restoranteve dhe hotelerisë (1.4 p.p.).


Në muajin janar të vitit 2025, çmimet në kategorinë e produkteve ushqimore dhe pijeve joalkoolike, ishin 5.7% dhe shënuan përsheptim të lehtë të rritjes në krahasim me muajin paraprak (5.6 në muajin dhjetor), me ç'rast kontributi i kësaj kategorie në inflacionin e përgjithshëm në muajin dhjetor ishte 2.3 p.p., ku kontributi mbeti i pandryshuar në krahasim me muajin e kaluar. Kontributin më të madh pozitiv në rritjen e kategorisë së produkteve ushqimore dhe pijeve joalkoolike kishin nënkategoritë: perimet (rritje vjetore prej 10.0% dhe kontribut prej 0.5 p.p), qumështi, djathi dhe vezët (rritje vjetore prej 6.9% dhe kontribut prej 0.5 p.p), mishi (rritje vjetore prej 4.6% dhe kontribut prej 0.4 p.p.), pijet joalkoolike (rritje vjetore prej 16.0% dhe kontribut prej 0.4 p.p), vaji (rritje vjetore prej 11.8% dhe kontribut prej 0.2 p.p të gjitha me kontribut prej 0.2 p.p.) dhe buka, drithërat (rritje vjetore prej 2,2% dhe kontribut prej 0.2 p.p.).

Sipas komponentëve, rritja më e lartë vjetore e çmimeve në muajin janar të vitit 2025 u shënuar në kategorinë e restoranteve dhe hotelerisë për 11.4% (kontributi në rritjen e inflacionit të përgjithshëm prej 0.7 p.p). Rritje të çmimeve u regjistrua edhe në këto kategori: rekreacioni dhe kultura prej 6.5%, mallrat dhe shërbimet e ndryshme prej 5.8%, transporti prej 5.7%, pijet alkoolike, duhani dhe lëndët narkotike prej 5.2¹%, mbrojtja shëndetësore prej 3.9%, mobilitet, amvisëria dhe mirëmbajtja e pajisjeve elektroshtëpiake prej 3.6%, kategoria e veshjeve dhe këpucëve prej 3.9%, komunikimet prej 1.5%, banimi, uji, elektrika, gazi dhe karburantet e tjera prej 1.4% dhe arsimi prej 0.3%.

Grafiku 1.14: Struktura e inflacionit sipas COICOP
(kontribute në p.p.)



Grafiku 1.15: Inflacioni (normat vjetore të rritjes në %) për vendet nga Ballkani
Perëndimor




¹ Çmimi i produkteve të duhanit është rritur në përputhje me ndryshimet e miratuara në Ligjin e Akcizave, akciza e cigareve do të rritet për 0.23 denarë për copë çdo vit deri në vitin 2030. Çmimi i ri i duhanit u vendos në muajin tetor të vitit 2024.



Çmimet e konsumit në muajin janar u rritën për 0.2% në nivel mujor (çmimet në muajin e kaluar u rritën për 0.3%). Rritja e çmimeve në nivel mujor vjen si rezultat i rritjes së inflacionit bazë. Këtë muaj, çmimet e produkteve ushqimore janë rritur për 0.1% në nivel mujor dhe stabilizimi i tyre i detyrohet pjesërisht masës për uljen e marzheve për disa produkte ushqimore, e ashtuquajtura “Shporta e Vitit të Ri”, e cila ka hyrë në fuqi më datë 15.01.2025.


Çmimet me pakicë në muajin janar të vitit 2025 u rritën për 5.2% në nivel vjetor dhe ato shënojnë përshpejtim rritjeje. Në bazë mujore, çmimet me pakicë kanë shënuar ulje prej 0.4%.



Në muajin janar të vitit 2025 Eurozonë, norma e inflacionit shënoi rritje për 0.1 p.p. krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2024 që paraqet 2.5%². Sipas projeksioneve të BQE-së, norma e inflacionit në periudhë afatshkurte pritet të shënojë ulje të lehtë në 2.3% në vitin 2025, përpara se të bjerë në 1.9% në vitin 2026 dhe 2.0% në vitin 2027. Një ulje e lehtë e inflacionit të përgjithshëm pritet në vitin 2025. Kjo rezulton kryesisht për shkak të inflacionit më të lartë të ushqimeve dhe efekteve bazë në rritje të çmimeve të energjisë që neutralizojnë në masë të madhe ndikimet rënësë të inflacionit në rënie. Ashtu siç efektet bazë në inflacionin e energjisë zbehen, inflacioni i përgjithshëm pritet të bjerë në fillim të vitit 2026.

Çmimet e bursës

Në muajin janar të vitit 2025, çmimi i naftës së papërpunuar (Brent) në bursat botërore u rrit për 7.3% në nivel mujor dhe arriti në 79.2 dollarë për fuçi. Rritja erdhi si pasojë e disa faktorëve, me ç'rast një nga arsytet kryesore ishte vendosja e sanksioneve më rigorozë ndaj naftës ruse dhe iraniane, që reduktuan ofertën e naftës në treg, ndërsa vala e ftohtë në Amerikën Veriore solli rritjen e kërkesës. Në nivel vjetor, çmimi i naftës ishte më i ulët për 1.3%.



Në muajin janar të vitit 2025, çmimi i gazit natyror u rrit për 15.5% në nivel mujor. Çmimi i gazit ishte nën ndikimin e disa faktorëve, duke përfshirë tensionet gjeopolitike që e shtynë Rusinë ta ndërpresë rrjedhën e gazit në Evropë nëpërmjet Ukrainës, kushtet e motit dhe rezervat e reduktuara të

² Të dhënat janë vlerësim i Eurostat-it



gazit për shkak të reduktimit të prodhimit të gazit nga burimet e ripërtëritshme të energjisë. Këta faktorë, si dhe presionet ende të pranishme e rritën lëkundjen e tregut të gazit, duke sjellë jostabilitet më të madh. Në muajin janar të vitit 2025, çmimi i gazit natyror u rrit për 36.9% në nivel vjetor.

Çmimi i energjisë elektrike në muajin janar të vitit 2025 sipas Bursës Hungareze të Energjisë Elektrike (HUPX) ishte 140.19 euro për megvat/orë dhe në nivel mujor u regjistrua rënie prej 0.9%. Çmimet e energjisë elektrike shënuan ulje, pas rritjes në muajt e mëparshëm, për shkak të rritjes së çmimit të gazit natyror dhe rritjes së kërkesës. Këtë muaj, çmimi i energjisë elektrike është rritur për 63.5% në nivel vjetor.

Në muajin janar të vitit 2025, çmimet e metaleve bazë regjistruan ulje krahasuar me muajin paraprak: zinku për 7.1%, plumbi për 3.5% dhe nikeli për 0.3%. Rritje të çmimeve janë regjistruar në nivel mujor: çmimi i kallait për 2.6%, aluminit 1.3% dhe bakrit për 0.8%.

Gjatë këtij muaji, çmimet e arit dhe platinit shënuan rritje në nivel mujor përkatësisht për 2.3% dhe 1.2%. Çmimi i argjendit shënoi rënie prej 1.1% në nivel mujor.

Në muajin janar, çmime e misrit dhe grurit u rritën në nivel mujor përkatësisht për 5.8% dhe 0.1%. Çmimi i vajit të lulediellit është ulur në nivel mujor për 1.3%.




Tabela 1.1. Çmimet energjensave në bursa (të dhëna mujore)

	Electricity (EUR/MWh) Energjia elektrike	Crude Oil, Brent (\$/bbl) Nafta bruto, Brent	Natural GAS, Europe (\$/1000 m3) Gazi natyror, Evropë
2023 I	148,7	83,1	714,1
II	146,2	82,7	585,1
III	113,4	78,5	488,7
IV	106,7	84,1	478,4
V	88,2	75,7	357,7
VI	96,6	74,9	366,2
VII	94,5	80,1	337,2
VIII	100,4	86,2	396
IX	103,8	94,0	408,6
X	104,9	91,1	515,5
XI	99,38	83,2	512,5
XII	81,72	77,9	407,1
2024 I	85,73	80,2	338,2
II	69,35	83,8	288,3
III	65,12	85,5	302,6
IV	61,96	90,5	321,4
V	72,2	82,0	358,2
VI	91,7	82,6	384,6
VII	135,5	85,3	366,1




VIII	120,8	80,9	437,8
IX	106,1	74,3	416,94
X	92,2	75,7	457,1
XI	163,7	74,4	492,7
XII	143,9	73,8	490,3
2025 I	140,2	79,2	518,8

Burimi: Banka Botërore, Bursa Hungareze e Energjisë Elektrike (World Bank, Hungarian Power Exchange)/

2. SHKËMBIMI I JASHTËM TREGTAR

Shkëmbimi i jashtëm tregtar i përgjithshëm në vitin 2025 ishte 1.428,0 milionë euro, me ç'rast shënoi rritje prej 5.7%, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak.


Në vitin 2025, pjesëmarrja e shkëmbimit me Bashkimin Evropian (BE 27³), si partneri më i madh tregtar është ulur për 4.2 p.p, krahasuar me muajin janar të vitit 2024 dhe është 59.5%. Gjermania është partnerja më e rëndësishme tregtare e vendit tonë. Në strukturën e përgjithshme të shkëmbimit të jashtëm tregtar të vendit tonë, pjesëmarrja e shkëmbimit tregtar me Gjermaninë në muajin janar të vitin 2025 ishte 20.6% dhe është ulur për 2.7 p.p. krahasuar me muajin e njëjtë në vitin 2024.



Eksporti

Vlera e mallrave të eksportuara në muajin janar të vitit 2025 ishte 578.9 milionë euro dhe shënoi rritje prej 5.1% (28.3 milionë euro), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024, ndërsa vëllimi fizik i eksportit u rrit për 6.0%, krahasuar me muajin janar të vitit 2024.

Analizuar në nivel mujor, në muajin janar të vitit 2025, eksporti shënoi rritje prej 2.5% (14,3 milionë euro), krahasuar me muajin paraprak edhe nëse ndryshohen kuotat e eksportit në aspektin sezonal, ku ai regjistroi rritje mujore prej 10.1%, që do të thotë ndikim negativ të faktorit sezonal (7.5 p.p.) kundrejt eksportit të këtij muaji.



³ Започнувајќи од јануари 2021 година, Велика Британија се распределува во групацијата - Останати земји Duke filluar nga muaji janar i vitit 2021, Britania e Madhe kalon në grupin – Vende të tjera






Vlera e eksportit të produkteve ushqimore në muajin janar të vitit 2025 është rritur për 4.5 milionë euro, që do të thotë rritje prej 16.0% krahasuar me muajin janar të vitit 2024, ndërsa sasia e eksportuar e produkteve ushqimore ka shënuar rritje për 5.2%. Në strukturën e përgjithshëm të eksportit të vendit tonë, në muajin janar të vitit 2025, pjesëmarrja e produkteve ushqimore është 5.7% dhe është rritur për 0.5 p.p. krahasuar me muajin janar të vitit 2024.

Sipas analizës të grupeve ekonomike⁴ të vendeve, në muajin janar të vitit 2025 krahasuar me muajin janar të vitit 2024, eksporti ka shënuar rritje në këto grupe: BE 27, EFTA, Ballkani Perëndimor, Zona e Tregtisë së Lirë e Amerikës Veriore dhe Bashkësia e Shteteve të Pavarura, ndërsa rënie ka pasur në këto grupe: Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës dhe Derivateve të Naftës, si dhe Organizata Ekonomike e Bashkëpunimit të Rajonit të Azisë-Paqësorit. Eksporti në BE 27 shënoi rritje vjetore prej 2.7%, ndërsa në vendet e Ballkanit Perëndimor rritje prej 10.9%. Përveç kësaj, pjesëmarrja e eksportit të mallrave në BE 27 dhe vendet e Ballkanit Perëndimor në eksportin e përgjithshëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut është përkatësisht 77.6% dhe 12.0%.

Importi

Vlera e importit në muajin janar të vitit 2025 ishte 849.1 milionë euro që paraqet rritje prej 6.1% (48.6 milionë euro), krahasuar me muajin e njëjtë të vitit 2024, ndërsa sasi të importuara të mallrave u



⁴ Grupet ekonomike përfshijnë vendet e mëposhtme: BE 27 (Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Republika Çeke, Gjermania, Danimarka, Estonia, Spanja, Finlanda, Franca, Greqia, Hungaria, Irlanda, Italia, Lituania, Luksemburgu, Letonia, Malta, Holanda, Polonia, Portugalia, Rumania, Suedia, Sllovenia dhe Sllovakia); EFTA (Zvicra, Islanda, Lihtenshtajni dhe Norvegjia); Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës dhe Derivateve të Naftës (Emiratet e Bashkuara Arabe, Angola, Algjeria, Ekuadori, Iraku, Irani, Kuvajti, Libia, Nigeria, Katari, Arabia Saudite dhe Venezuela); Ballkani Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Serbia); Zona e Tregtisë së Lirë e Amerikës së Veriut (Kanadaja, Meksika dhe SHBA-ja); Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik e rajonit të Azisë-Paqësorit (Australia, Brunei, Kanadaja, Kili, Kina, Hong Kongu, Indonezia, Japonia, Koreja, Meksika, Malajzia, Zelanda e Re, Peruja, Papua Guinea e Re, Filipinet, Rusia, Singapori, Tajlanda, Tajvani, SHBA-ja dhe Vietnam) dhe Bashkësia e Shteteve të Pavarura (Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Kirgistani, Kazakistani, Moldavia, Rusia, Taxhikistani, Turkmenistani, Ukraina dhe Uzbekistani).



rritën për 18.6% krahasuar me muajin janar të vitit 2024.

Sipas analizës në nivel mujor, në muajin janar të vitit 2025, importi shënoi rënie prej 9.2% (86.2 milionë euro), krahasuar me muajin paraprak dhe nëse ndryshohen kuotat e importit në aspektin sezonal, ai shënon rritje mujore prej 6.1%, që tregon ndikimin negativ të faktorit sezonal (15.3 p.p.) mbi importin këtë muaj.

Vlera e importit të produkteve ushqimore në muajin janar të vitit 2025 është rritur për 5.8 milionë euro, që paraqet rritje prej 6.8%, krahasuar me muajin janar të vitit 2024, ndërsa sasia e produkteve ushqimore të importuara u rrit për 5.4%. Në muajin janar të vitit 2025, pjesëmarrja e produkteve ushqimore në strukturën e importit të përgjithshëm në vendin tonë është 10.7% dhe është rritur për 0.1 p.p. krahasuar me muajin e njëjtë të vitit 2024.


.Tabela 2.1. Pasqyra e eksportit dhe importit të grupeve të përzgjedhura të produkteve

Eksporti i naftës dhe produkteve të naftës*)					Importi i naftës dhe produkteve të naftës*)				
	I - 2024	I - 2025	Saldo	Normat në %		I - 2024	I - 2025	Saldo	Normat në %
.000 T	6,0	6,9	0,9	14,3	.000 T	93,8	83,4	-10,4	-11,1
Mil. EURO	4,9	5,2	0,3	6,1	Mil. EURO	67,2	61,1	-6,1	-9,1
Mil.\$	5,4	5,4	0,0	0,6	Mil.\$	73,4	63,1	-10,2	-13,9
*)Të dhënat paraprake									
Eksporti i produkteve kimike*)					Importi i produkteve kimike*)				
	I - 2024	I - 2025	Saldo	Normat në %		I - 2024	I - 2025	Saldo	Normat në %
.000 T	1,5	2,9	1,5	102,9	.000 T	1,8	2,1	0,3	15,8
Mil. EURO	127,0	119,5	-7,5	-5,9	Mil. EURO	11,9	11,0	-0,9	-7,9
Mil.\$	138,4	123,9	-14,5	-10,5	Mil.\$	13,0	11,3	-1,6	-12,5
*)Të dhënat paraprake									
Eksporti i hekurit dhe çelikut*)					Importi i hekurit dhe çelikut*)				
	I - 2024	I - 2025	Saldo	Normat në %		I - 2024	I - 2025	Saldo	Normat në %
.000 T	64,8	63,9	-1,0	-1,5	.000 T	45,9	64,7	18,9	41,2
Mil. EURO	50,7	45,4	-5,3	-10,4	Mil. EURO	31,4	39,2	7,8	24,7
Mil.\$	55,3	47,0	-8,3	-15,0	Mil.\$	34,3	40,6	6,3	18,4
*)Të dhënat paraprake									

Saldoja e shkëmbimit tregtar

Në muajin janar të vitit 2025, deficitit tregtar u rrit për 8.1%, përkatësisht 20.3 milionë euro, krahasuar me muajin janar të vitit 2024.

Nëse analizojmë saldon e eksportit dhe importit të mallrave sipas destinimit ekonomik, rritja e deficitit është rezultat i rritjes së deficitit në shkëmbim me: furnizimet industriale, mallrat e konsumit të gjerë, produktet





ushqimore dhe pijet, karburantet, lubrifikantët dhe mallrat për investime, pa përfshirë pajisjet e transportit, si dhe uljes së saldos pozitive në shkëmbim me pajisjet e transportit.

Në muajin janar të vitit 2025, 98.1% e deficitit tregtar të vendit është realizuar në shkëmbim me Mbretërinë e Madhe, Kinën dhe Greqinë dhe mandej vijojnë Turqia, Serbia, Polonia, Italia, Bullgaria e të tjera. Suficiti u arrit në shkëmbimin me Gjermaninë, Kosovën, Çekinë, SHBA-në dhe të tjera.

Struktura valutore

Sa i përket aspektit të strukturës valutore, 90.5% e shkëmbimit tregtar në muajin janar të vitit 2025 është realizuar në euro, ku krahasuar me muajin janar të vitit 2024 paraqet rënie për 2.6 p.p.. Në anën e eksportit dhe importit, valuata euro përfaqësohet përkatësisht me 91.5% dhe 89.9%, ndërsa sa i përket importit u zvogëluar për 1.8 p.p., krahasuar me muajin janar të vitit 2024.

Tabela 2.2 Shkëmbimi tregtar i Republikës së Maqedonisë së Veriut (sipas valutave); përlogaritjet e MF-së												
Importi	I - XII - 2023					I - XII - 2024					ndryshim absolut në vlerën e valutës	ndryshimi relativ në vlerën e valutës (në %)
valuta	sasia.000 t	importi në valutë	kursi mesatar i denarit kundrejt valutave	importi në denarë	strukt. në%	sasia.000 t	importi në denarë	kursi mesatar i denarit kundrejt valutave	importi në denarë	strukt. në%		
EYP	432,5	733.499.021	61,6065	45.188.307.437	91,6	516,5	762.998.062	61,5437	46.957.723.826	89,9	29.499.041	4,0
USD	40,1	65.408.074	56,4449	3.691.952.190	7,5	44,0	82.267.044	59,4947	4.894.453.097	9,4	16.858.970	25,8
GBP	0,2	1.884.045	71,6862	135.060.015	0,3	0,1	1.157.933	73,4025	84.995.203	0,2	-726.111	-38,5
EURO+US D+GPB	472,8	0	0	49.015.319.643	99,1	560,6	0	0	51.937.172.126	99,4	0	0,0
vk eksporti	473,9	0	0	49.327.352.744	100,0	562,1	0	0	52.262.062.177	100,0	0	5,9
Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave dhe BPRMV-ia												

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave dhe BPRMV-ja

3. SEKTORI FISKAL

Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore sipas klasifikimit ekonomik

Në muajin janar të vitit 2025 realizimi i përgjithshëm i të hyrave buxhetore të Buxhetit të RMV-së ishte 23.313 milionë denarë, që paraqet 6.5% të vlerës së planifikuar për vitin 2025, përkatësisht rritje prej 8.7% krahasuar me të hyrat e realizuara buxhetore në muajin janar të vitit 2024. Në kuadër të të hyrave të përgjithshme janë realizuar 21.170 milionë denarë në bazë të të hyrave tatimore dhe kontributeve sociale, ku norma e realizimit është 6,6% nga vlera e planifikuar për vitin 2025, përkatësisht rritje prej 7.5% krahasuar me vitin paraprak. Gjithashtu, janë realizuar të hyra tatimore në vlerë të përgjithshme prej 13.125 milionë denarëve (realizim prej 6.6% nga vlera e planifikuar për vitin 2025), ndërsa kontributet janë realizuar në vlerë prej 7.955 milionë denarëve (rritje vjetore prej 12.5%, përkatësisht 6.8% e vlerës së planifikuar për vitin 2025). Në kuadër të të hyrave tatimore, ka rritje të të hyrave në bazë të: tatimit mbi të ardhurat personale për 9.6%, tatimit mbi vlerën e shtuar për 4.0%, akcizës për 2.2% dhe detyrimeve të importit për 18.9%, ndërsa tatimi mbi fitimin shënon ulje për 2.8 dhe të hyrat e tjera tatimore për 19.0%. Në muajin janar të vitit 2025, të hyrat jotatimore shënuan rritje prej 19.8% dhe të hyrat nga donacionet e jashtme për 60.1%, ndërsa të hyrat kapitale shënuan rënie prej 5.0%.

Realizimi i shpenzimeve të përgjithshme në muajin janar të vitit 2025 arrin në 26.019 milionë denarë, që paraqet 6.5% të planit vjetor, përkatësisht ulje prej 3.4%, krahasuar me muajin janar të vitit 2024. Njëkohësisht, janë realizuar shpenzime rrjedhëse në vlerë prej 25.572 milionë denarëve, përkatësisht 7.2% nga vlera e planifikuar për tërë vitin, që paraqet rritje prej 6.3%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024. Rritje kanë shënuar edhe shpenzimet për pagat dhe kompensimet për 9.2%, shpenzimet për mallra dhe shërbime me 9.3% dhe shpenzimet e interesit për 42.8%. Transfertat, të cilat janë kategoria më e madhe e shpenzimeve rrjedhëse, u rritën për 2.5%, të nxitura nga rritja e transfertave sociale me 3.8%, shpenzimet e mbrojtjes shëndetësore për 6.2%, dotacionet bllok dhe ato të destinuara për 6.7%. Këtë muaj, shpenzimet në bazë të subvencioneve dhe transfertave janë ulur për 16.6%. Realizimi i shpenzimeve kapitale arritën në vlerë prej 447 milionë denarëve dhe janë 84.6%




krahasuar me muajin janar të vitit 2024. Norma e realizimit të shpenzimeve kapitale në këtë periudhë krahasuar me vlerën e planifikuar ishte 0.95%.

Tabela 3.1. Realizimi i Buxhetit të RMV-së në muajin janar të vitit 2025


	Buxheti 2025	Janar 2025		
	milona denarë	miliona denarë	norma vjetore e rritjes (në %)	norma e realizimit
TË HYRA TË PËRGJITHSHME	358.838	23.313	8,7%	6,5%
Tatime dhe kontribute	319.234	21.170	7,5%	6,6%
Tatime	198.607	13.125	4,9%	6,6%
Tatimi mbi të ardhurat personale	35.676	2.305	9,6%	6,5%
Tatimi mbi fitimin	23.287	1.072	-2,8%	4,6%
TVSH	86.692	6.278	4,0%	7,2%
Akciza	35.388	2.364	2,2%	6,7%
Detyrime të importit	16.255	1.038	18,9%	6,4%
Të hyra të tjera tatimore	1.309	68	-19,0%	5,2%
Kontribute	117.095	7.955	12,5%	6,8%
Të hyra jotatimore	26.302	1.795	19,8%	6,8%
Të hyra kapitale	3.510	95	-5,0%	2,7%
Donacione të jashtme	9.792	253	60,1%	2,6%
Të hyra nga huatë e arkëtuara	0	0		
SHPENZIME TË PËRGJITHSHME	400.188	26.019	-3,4%	6,5%
Shpenzime rrjedhëse	353.032	25.572	6,3%	7,2%
Paga dhe kompensime	48.141	3.670	9,2%	7,6%
Mallra dhe shërbime	26.325	1.201	9,3%	4,6%
Transferta	257.721	18.494	2,5%	7,2%
Transferta sociale	191.046	14.609	3,8%	7,6%
SPIMV	119.995	9.529	2,8%	7,9%
Kompensimi financiar për personat e papunësuar	3.439	130	56,6%	3,8%
Ndihmë sociale	15.080	1.202	0,7%	8,0%
Mbrojtje shëndetësore	52.531	3.748	6,2%	7,1%
Transferta të tjera	64.211	3.787	-2,1%	5,9%
Interesi	20.845	2.207	42,8%	10,6%
Shpenzime kapitale	47.156	447	-84,6%	0,9%
SALDO BUXHETORE	-41.350	-2.706	-50,8%	6,5%



Grafiku 3.1. Struktura e të hyrave të tjera tatimore të realizuara, janar 2025




Grafiku 3.2. Struktura e shpenzimeve të realizuara sipas klasifikimit ekonomik, janar 2025



Në muajin janar të vitit 2025, deficitin buxhetor i RMV-së u realizua prej 2.706 milionë denarëve, që paraqet 0.3% të PBB-së e projektuar për vitin 2025, përkatësisht 6.5% të planit vjetor.

Grafiku 3.3. Deficitin buxhetor, të dhënat kumulative (mil. denarë)




Shpenzimet sipas shfrytëzuesve buxhetorë

Në vijim është dhënë pasqyrë për shpenzimet buxhetore të shfrytëzuesve buxhetorë më të mëdhenj.

Në muajin janar të vitit 2025, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë ka realizuar 9.798 milionë denarë ose 14.3% nga buxheti i përgjithshëm për vitin rrjedhës. Po ashtu, pjesa më e madhe (83.3%) e shpenzimeve ishin të destinuara për transferta rrjedhëse në fondet jashtëbuxhetore, për të cilat u shpenzuan 8.164 milionë denarë, përkatësisht 17.0% nga mjetet e destinuara për vitin 2025. Zëri i dytë më i rëndësishëm i shpenzimeve janë përfitimet sociale, me

Grafiku 3.4: Struktura e shpenzimeve sipas shfrytëzuesve buxhetorë dhe ndarjeve (janar 2025)





pjesëmarrje prej 11.9% në shpenzimet e përgjithshme dhe për këtë qëllim janë realizuar 8.1% (1.168 milionë denarë) nga planifikimi për vitin 2025.

Në periudhën e analizuar, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka realizuar mjete buxhetore në vlerë prej 3.073 milionë denarëve, që është 7.1% e buxhetit të përgjithshëm për vitin 2025. Pjesa më e madhe e shpenzimeve (61.9%) paraqesin transferta rrjedhëse në NJVL, për të cilat janë shpenzuar 1.903 milionë denarë, ose 7.9% e mjeteve të përgjithshme të planifikuara. Pagat dhe kompensimet janë zëri i dytë më i rëndësishëm me pjesëmarrje prej 22.4%, për të cilat janë shpenzuar 688 milionë denarë, përkatësisht 7.4% e mjeteve të përgjithshme të planifikuara.

Në muajin janar të vitit 2025, Ministria e Punëve të Brendshme ka realizuar mjete buxhetore në vlerë prej 965 milionë denarëve, që është 6.0% e buxhetit vetanak për vitin 2025. Zëri më i rëndësishëm i shpenzimeve janë pagat dhe kompensimet me pjesëmarrje prej 81.7%, për të cilat janë shpenzuar 788 milionë denarë, përkatësisht 8.0% e mjeteve të planifikuara. Zëri i dytë më i rëndësishëm janë mallrat dhe shërbimet me pjesëmarrje prej 13.4%. Për këtë qëllim janë realizuar 130 milionë denarë, përkatësisht 4.1% e planit vjetor.

Në këtë periudhë Agjencia e Përkrahjes Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural (APFBZHR) ka realizuar 15 milionë denarë, që paraqet 0.2% të mjeteve të planifikuara për vitin rrjedhës. Për paga dhe kompensime, të cilët janë me pjesëmarrje prej 82.1% në shpenzimet e përgjithshme janë realizuar 7.7% nga mjetet e planifikuara për tërë vitin, përkatësisht 13 milionë denarë.

Në muajin janar të vitit 2025, Ministria e Mbrojtjes ka realizuar 923 milionë denarë, që është 4.5% nga buxheti i përgjithshëm për këtë vit. Pjesëmarrjen më të madhe në shpenzimet e kanë pagat dhe kompensimet me 57.6%, për këtë qëllim realizimi arrin në 532 milionë denarë (7.9% nga mjetet e përgjithshme të parashikuara për vitin rrjedhës). Mallrat dhe shërbimet kanë pjesëmarrje prej 28.0% në shpenzimet e përgjithshme dhe për këtë zë janë shpenzuar 259 milionë denarë, përkatësisht 7.3% nga mjetet e përgjithshme të parashikuara.

Në muajin janar të vitit 2025, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka realizuar gjithsej 622 milionë denarë, përkatësisht 9.1% nga mjetet e planifikuara për vitin 2025. Po ashtu, subvencionet dhe transfertat kanë pjesëmarrje prej 69.3% nga shpenzimet e përgjithshme të këtij shfrytëzuesi buxhetor dhe janë realizuar në vlerë prej 431 milionë denarëve (8.3% nga mjetet e parashikuara).

Në periudhën e analizuar, Ministria e Shëndetësisë ka realizuar mjete buxhetore në vlerë prej 69 milionë denarëve, përkatësisht 0.9% nga buxheti i përgjithshëm për vitin 2025. Pjesëmarrjen më të madhe sa i përket shpenzimeve e kanë mallrat dhe shërbimet me 42.2%, për të cilat janë shpenzuar 29 milionë denarë ose 0.8% nga mjetet e destinuar për vitin 2025. Zëri i dytë më i theksuar janë shpenzimet kapitale me realizim prej 24 milionë denarëve (4.2% nga mjetet e planifikuar për vitin) dhe me pjesëmarrje prej 35.1% në shpenzimet e përgjithshme.

Në periudhën janar të vitit 2025, Ministria e Transportit ka realizuar mjete në vlerë prej 92 milionë denarëve, që është 0.5% e buxhetit të përgjithshëm për vitin rrjedhës. Realizimi i shpenzimeve kapitale si zë kryesor është 67.8% nga mjetet e përgjithshme të realizuara të këtij shfrytëzuesi buxhetor (62 milionë denarë ose 0.4% nga mjetet e përgjithshme të planifikuara).

Në këtë periudhë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave ka realizuar mjete në vlerë prej 78 milionë denarëve, që paraqet 4.3% nga vlera e parashikuar për vitin 2025. Pagat dhe kompensimet (66 milionë denarë) janë zëri më i theksuar në shpenzimet e përgjithshme të këtij shfrytëzuesi buxhetor me pjesëmarrje prej 83.6%, ndërsa janë realizuar 7.7% nga të planifikimi. Në bazë të mallrave dhe shërbimeve përbëjnë 8.1% nga shpenzimet e përgjithshme, ndërsa realizimi për këtë qëllim ishte 6 milionë denarë ose 2,6% nga buxheti i përgjithshëm për këtë qëllim.

Të dhënat e detajuara për secilin shfrytëzues buxhetor janë paraqitur në shtojcën statistikore në linkun në vijim (<http://finance.gov.mk/lëvizjet-ekonomike-afatshkurtra-ked-me/>).



4. SEKTORI SOCIAL

Personat e sapopunësuar dhe personat e regjistruar si të papunë në Agjencinë e Punësimit

Në muajin janar të vitit 2025, në Agjencinë e Punësimit ishin regjistruar gjithsej 15.153 marrëdhënie pune të sapokrijuara. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023, numri i përgjithshëm i personave të sapopunësuar është ulur për 7.6%.


Nga numri i përgjithshëm i personave të sapopunësuar, 42.9% janë persona të punësuar me kohë të pacaktuar, ndërsa pjesa tjetër me kohë të caktuar dhe për kryerjen e punëve sezonale. Nga numri i përgjithshëm i marrëdhënieve të sapokrijuara të punës, në muajin janar të vitit 2025, 14.3% janë nga evidenca e personave të papunësuar.

Numri i përgjithshëm i personave të papunësuar, në muajin janar të vitit 2025 ishte 140.947, nga të cilët 96.731 persona janë kërkues aktivë të punës, ndërsa 44.216 janë pjesa tjetër e personave të papunë. Në bazë vjetore, numri i përgjithshëm i personave të papunë është ulur për 7.7%, ndërsa duke filluar nga muaji maj i vitit 2021, ai shënoi rënje vjetore të vazhdueshme. Krahasur me muajin dhjetor të vitit 2024, numri i të papunëve është ulur për 1 person.

Pjesa më e madhe e personave aktivë të papunë (58.7%) janë persona që jetojnë në qytet, ndërsa sipas strukturës gjinore 48.1% janë meshkuj. Sipas shkallës së arsimit, pjesa më e madhe e personave të papunë, përkatësisht 68.8% kanë arsim të mesëm jo të plotë ose më pak se atë, 23.6% me arsim të mesëm të përfunduar, ndërsa 7.6 % me arsim të lartë ose më të lartë.


Sipas analizës së strukturës së moshës, 49.9% e të papunëve bëjnë pjesë në grupin e moshës madhore nga 25 deri 49 vjeç. Sipas kohës së pritjes së punësimit, 60.3% e personave të papunë presin të punësohen prej 1 deri në 7 vjet, ndërsa 13.5% presin 8 vjet ose më shumë.

Grafiku 4.1: Pasqyra e personave të papunësuar (vlerat në njësi)




Burimi: APRMV

Grafiku 4.2: Pasqyra e punësimeve të reja (vlerat në njësi)



Burimi: APRMV

Grafiku 4.3: Paga mesatare neto (normat vjetore të rritjes në %)



Burimi: ESHS






Pagat

Sipas kumtesës së Entit Shtetëror të Statistikave, paga mesatare nominale neto në muajin dhjetor të vitit 2024 ishte 43.587 denarë dhe shënoi rritje vjetore prej 9.0%, ndërsa krahasuar me muajin nëntor të vitit 2024, ajo është më e lartë për 3.8%. Paga mesatare më e lartë neto është paguar në muajin dhjetor të vitit 2023 vërehet në këto sektorë: veprimtaria ndihmëse administrative dhe shërbyese (13.2%), transporti dhe magazinimi (12.3%) dhe minierat dhe guroret (12.0%). Në muajin dhjetor të vitit 2024, pagat reale shënojnë rritje vjetore prej 4.4%. Paga më e lartë mesatare neto në muajin dhjetor të vitit 2024 ishte paguar në sektorin e informacionit dhe komunikimit (80.695 denarë), me ç'rast vlera më e lartë e pagës neto është paguar në veprimtarinë e programimit kompjuterik, konsultimeve dhe veprimtarive të ndërlidhura (101.972 denarë), më tej vijojnë veprimtaritë financiare dhe veprimaritë e sigurimve me 60.657 denarë, sektori i minierave dhe guroreve me 56.631 denarë dhe sektori i furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të koindicionuar me 55.258 denarë.

Paga mesatare nominale bruto në muajin dhjetor të vitit 2024 ishte 65.582 denarë dhe krahasuar me muajin e njëjtë të vitit 2023 u rrit për 9.2%, ndërsa në bazë mujore për 3.8%. Rritja më e theksuar e pagës mesatare bruto në muajin dhjetor të vitit 2024, krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2023 u shënuar në sektorët: veprimtaria e shërbimeve administrative dhe ndihmëse (13.3%), transporti dhe magazinimi (12.5%) dhe minierat dhe guroret (12.2%).

Pensionet

Në muajin janar të vitit 2025, në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor ishin evidentuar 341.621 pensionistë. Në muajin shtator të vitit 2024 u ndryshuar Ligji i Sigurimit Pensional dhe Invalidor, ku sipas të cilit, më datën 01.10.2024 kishte rritje lineare për të gjitha llojet e pensioneve për 2.500 denarë. Nga numri i përgjithshëm i pensionistëve, 71.0% janë shfrytëzues të pensionit të pleqërisë ose 242.520 pensionistë, 21.6% pensione familjare ose 73.863 pensionistë dhe 7.4% pensione invaliditeti ose 25.238 pensionistë.





Pensioni mesatar në muajin janar të vitit 2025 ishte 23.709 denarë, përkatësisht për 17.9 % më i lartë se muaji i njëjtë i vitit 2024⁵. Rritja e pensioneve, ndër të tjera, vjen si rezultat i harmonizimit të pensioneve në muajin mars, sipas metodologjisë që parasheh harmonizimin e pensioneve me model të kombinuar prej 50% rritje të pagës mesatare dhe 50% rritje të kostos së jetesës, sipas të dhënave zyrtare të ESHS-së. Sipas kësaj metodologjie, duke filluar nga muaji mars i vitit 2022, harmonizimi kryhet dy herë në vit, respektivisht në muajt mars dhe shtator.

Raporti i pensionit mesatar me pagën e paguar mesatare në muajin dhjetor të vitit 2024 (të dhënat e fundit në dispozicion) shënon 54.5%.

Pensioni mesatar i pleqërisë në muajin janar të vitit 2025 ishte 25.349 denarë, pensioni mesatar invalidor ishte 21.273 denarë, ndërsa pensioni mesatar familjar 19.158 denarë. Për pagesën e pensioneve këtë muaj ishin harxhuar 8.061 milionë denarë, që paraqet 55.2% nga transfertat e përgjithshme sociale.

Tabela 4.1 Të dhënat e të ardhurave pensionale për muajin janar të vitit 2025

Shfrytëzuesit e pensionit	numri	struktura	paga mesatare
pleqërie	242.520	71,0%	25.349,00
invalidore	25.238	7,4%	21.273,00
familjar	73.863	21,6%	19.158,00
Gjithsej	341.621	100,0%	23.709,00
Shfrytëzuesit në minimum pensionet bujqësore	36		13.398,00
Shfrytëzuesit e pensioneve ushtarake	726		32.315,00
Gjithsej	342.383		23.726,00
Burimi: Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Republikës së Maqedonisë së Veriut			

5. SEKTORI MONETAR FINANCIAR

Në muajin janar të vitit 2025, Banka Popullore mbajti normën bazë të interesit, në nivel prej 5.55%, pasi filloi ta zvogëlonte atë nga muaji shtator. Vendimi për lehtësimin e politikave monetare bazohet në vlerësimin e inflacionit në zhvillimet më të fundit të treguesve kryesorë makroekonomikë dhe në lëvizjet e favorshme në tregun devizor. Ky zvogëlim është në përputhje me politikën monetare të BQE-së, që filloi uljen e normave të interesit që nga muaji shtator i vitit 2024.

Në muajin janar të vitit 2025, Banka Popullore i ka mbajtur depozitat njëditore dhe shtatëditore të disponueshme respektivisht në nivel 3.95% dhe 4.00%.


⁵ Gjatë përlllogaritjes së pensionit mesatar nuk janë përfshirë pensionet ushtarake dhe bujqësore.



Paratë primare

Në muajin janar të vitit 2025, paratë primare⁶ janë ulur për 8.0% në nivel mujor. Ulja e parave primare rezulton nga rënia e mjeteve të përgjithshme likuide për 14.3% dhe parave të gatshme në qarkullim për 1.5%.


Në muajin janar të vitit 2025, paratë primare u rritën për 1.0% në nivel vjetor, si pasojë e rritjes së parave të gatshme në qarkullim për 14.3%, ndërsa mjetet e përgjithshme likuide u zvogëluan për 10.3%.



Potenciali i depozitave⁷

Në muajin janar të vitit 2025, depozitat e përgjithshme në banka u zvogëluan për 1.3% në nivel mujor. Analiza sektoriale tregon se krahasuar me muajin e kaluar depozitat e ndërmarrjeve janë ulur për 5.0%, ndërsa depozitat familjare janë rritur për 0.2%.

Nga aspekti valutor, në muajin janar të vitit 2025, krahasuar me muajin parapark, depozitat vendore dhe valutat e huaja regjistruan rënie, respektivisht prej 1.4% dhe 1.1%.



Në muajin janar të vitit 2025, depozitat e përgjithshme janë rritur prej 11.0% në nivel vjetor. Analiza valutore tregon se depozitat në valutën vendore u rritën për 16.1%, ndërsa depozitat në valutën e huaj për 4.3%.

Nga aspekti sektorial, depozitat e ndërmarrjeve kanë regjistruar rritje prej 5.7% në nivel vjetor, ndërsa depozitat familjare kanë regjistruar rritje prej 14.2%.

⁶ Paratë primare janë përllogaritur si shumë e parave të gatshme në qarkullim (duke përfshirë edhe paratë e gatshme në arkë), rezervës së detyrueshme në denarë dhe në deviza dhe tepërisë së mjeteve likuide mbi detyrimin për rezervën e detyrueshme.

⁷ BPRMV-ja publikoi të dhënat nga statistikat monetare, statistikat e institucioneve të tjera financiare dhe statistikat për normat e interesit, sipas metodologjisë së re. Ndryshimet metodologjike u realizuan për shkak të harmonizimit me rekomandimet e Manualit të sapopublikuar dhe Udhëzuesit të statistikave monetare dhe financiare të FMN-së nga viti 2016 (MFSMCG – IMF, 2016) dhe Misionit teknik të FMN-së në fushën e statistikave monetare dhe financiare në BPRMV të vitit 2015.



Tabela 5.1. Potenciali i depozitave dhe kredive në sektorin privat

Potenciali i depozitave dhe kredive në sektorin privat (janar 2025)	Në miliona denarë	Ndryshimi mujor	Ndryshimi vjetor
Potenciali i depozitave	592.750	-1,3%	11,0%
Sipas valutës:			
Denarë	351.388	-1,4%	16,1%
Valutë e huaj	241.362	-1,1%	4,3%
Sipas afatizimit:			
Afatshkurtër	221.666	-0,7%	1,7%
Afatgjatë	148.983	0,8%	23,8%
Kreditë në sektorin privat	494.098	-0,1%	11,3%
Sipas valutës:			
Denarë	303.317	-0,3%	18,1%
Valutë e huaj	190.781	0,3%	2,0%
Sipas afatizimit			
Afatshkurtër	76.472	0,7%	14,6%
Afatgjatë	401.476	-0,3%	11,3%

Burimi: BPRMV

Sipas afatizimit, depozitat afatshkurtra u rritën në nivel vjetor u rritën për 1.7%, ndërsa depozitat afatgjate u rritën për 23.8%.

Struktura valutore e depozitave vazhdon edhe më tej të mbetet stabile, me ç'rast pjesëmarrja e depozitave në valutë vendore dominon në bazën e depozitave, ku edhe këtë muaj pjesëmarrja ka shënuar 59.3%

Kreditë Bankare

Në muajin janar të vitit 2025, kreditë e përgjithshme bankare në sektorin privat janë ulur për 0.1% në nivel mujor, në rrethana të uljes së kreditimit të ndërmarrjeve për 0.4%, ndërsa kreditimi i familjeve regjistroi rritje për 0.2%.

Nga aspekti valutor, në nivel mujor kreditë në denarë shënuan ulje për 0.3%, ndërsa kreditë devizorë regjistruan rritje prej 0.3%.

Në bazë vjetore, në muajin janar të vitit 2025, kreditë e përgjithshme janë rritur për 11.3%, në rrethana të rritjes së kredive të ndërmarrjeve dhe kredive ndaj familjeve, respektivisht për 14.2% dhe 8.8%. Kreditë në valutën vendore janë rritur për 18.1%, ndërsa kreditë në valutë të huaj regjistruan rritje prej 2.0%.

Nga aspekti i afatizimit, kreditë afatgjate shënuan rritje vjetore për 11.3%, ndërsa kreditë afatshkurtra për 14.6%.




Normat e interesit të depozitave bankare

Në muajin janar të vitit 2025, norma e përgjithshme e interesit të kredive u ul për 0.09% p.p, krahasuar me muajin paraprak dhe ajo ishte 5.21%. Norma e interesit të kredive në denarë u rrit për 0.01 p.p., dhe është 5.72%, ndërsa norma e interesit të kredive divizore regjistroi rënie prej 0.23 p.p., dhe është 4.47%.

Në janar të vitit 2025, norma e përgjithshme e interesit për depozitat është rritur për 0.01 p.p. krahasuar me muajin e kaluar është 2.18%. Norma e interesit për depozitat në denarë është rritur për 0.02 p.p. dhe është 2.72%, ndërsa norma e interesit për depozitat devizore është ulur për 0.03 p.p. dhe është 1.65%.

Norma e interesit për kreditë e sapoaprovuara në denarë është 5.00%, ndërsa për kreditë e sapoaprovuara devizore 3.84%. Normat e interesit për depozitat e sapoproanuara në denarë dhe ato devizore janë 2.88% dhe 1.88%.




Tregu i kapitalit

Në tregun e kapitalit, qarkullimi i përgjithshëm i bursës në muajin janar të vitit 2025 u ul për 58.8% në nivel mujor, në rrethana të rënies së qarkullimit të transaksioneve bllok për 90.6% dhe rënies së qarkullimit të tregtimit klasik për 3.9%.

Qarkullimi i përgjithshëm në bursë në muajin janar të vitit 2025 arriti në 949.4 milionë denarë, që paraqet rritje prej 109.4% në nivel vjetor.

Në fund të muajit janar të vitit 2025,

Indeksi i Bursës së Maqedonisë IBM-10 arriti në 10.853,7 pikë indeksi, me ç'rast në nivel mujor u rrit për 12.0% dhe krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak për 67.7%.



Rezervat devizore

Vlera e rezervave devizore bruto në fund të muajit janar të vitit 2025 ishte 5.041,39 milionë euro dhe krahasuar me muajin paraprak shënoi rritje për 0.2%, ndërsa në raport me muajin janar të vitit 2024 për 16.2%.